

Perspektiva Gjinore dhe Pjesëmarrja e Grave në Dialogun për Normalizim

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) organizoi më 3 mars 2023, në Tiranë, Shqipëri, një tryezë të rrumbullakët për një grup përfaqësuesish të partive politike, deputetëve të parlamenteve dhe organizatave të shoqërisë civile nga Serbia dhe Kosova për të diskutuar çështjet që lidhen me përfshirjen e perspektivës gjinore në dialogun Kosovë-Serbi dhe rritjen e përfshirjes së grave në proces. Pjesëmarrësit rekomanduan që perspektiva gjinore duhet të merret parasysh në proceset e ardhshme, veçanërisht në fushat ku njëra gjini preket në mënyrë disproporcionale, dhe më shumë gra duhet të përfshihen në procesin e dialogut.

Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e miratuar 23 vjet më parë, ka kontribuar në integrimin gjinor në nivel global. Situatat pas konfliktit kanë dëshmuar rolin thelbësor të grave në proceset e ndërtimit të paqes. Por roli i tyre është edhe më thelbësor për ruajtjen e paqes. Këto çështje shpesh anashkalohe nga liderët që janë më të shqetësuar për çështjet si statusi ose fitoret politike. Kështu, me gratë në proceset e negocimit dhe implementimit, si dhe me përfshirjen e duhur të perspektivës gjinore, marrëveshjet janë zakonisht më gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe më të zbatueshme. Pyetja mbetet se si të përfshihen këto praktika dhe perspektiva në dialogun aktual Serbi-Kosovë. Pjesëmarrësit ofruan një sërë sugjerimesh.

Perspektiva dhe përfaqësimi

Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara u bën thirrje të gjithë aktorëve të përfshirë në negocimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të paqes të përfshijnë perspektivën gjinore. Pavarësisht kontributit në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e perspektivës gjinore në fushën e paqes dhe sigurisë, megjithatë, Rezoluta nuk përcakton se çfarë është perspektiva gjinore ose si duhet të aplikohet në kontekstin e një procesi të paqes. Nga viti 1990 deri në vitin 2010, vetëm 11 përqind e marrëveshjeve të paqes i referoheshin grave. Pas vitit 2000 (deri në 2015), mbi 27 përqind iu referuan grave.¹ Në proceset e paqes ndërmjet viteve 1992 dhe 2019, gratë përbënin “mesatarisht 13 përqind të negociatorëve, 6 përqind të ndërmjetësuesve dhe 6 përqind të nënshkruesve në proceset kryesore të paqes në mbarë botën.”²

Dispozitat kryesore gjinore në marrëveshjet e paqes kanë qenë a) kuotat gjinore për përfaqësimin politik dhe punësimin në qeveri, b) çështjet e pasluftës dhe drejtësinë tranzicionale, c) masat për

¹ Christine Bell, “Teksti dhe konteksti: Vlerësimi i Marrëveshjeve të Paqes për “Perspektivën e tyre Gjinore”, Punim Kërkimor, UN Women, New York, tetor 2015, fq. 13.

² “Pjesëmarrja e Grave në Proceset e Paqes”, Këshilli për Marrëdhëniet me Jashtë, <https://www.unwomen.org/en/what-we-do/peace-and-security/facts-and-figures>.

të luftuar dhunën ndaj grave dhe d) fuqizimi dhe zhvillimi ekonomik i grave si të drejtat pronësore dhe të drejtat e trashëgimisë.³

Hulumtimet tregojnë se dispozitat gjinore janë më të mundshme kur gratë janë pjesë e këtyre negociatave. Prania e grave në proceset e përcaktimit të agjendës është politikisht e rëndësishme. Gratë u bënë palë në shumë negociata zyrtare, duke përfshirë në Burundi, Afganistan dhe në një dialog të brendshëm në Republikën Demokratike të Kongos. Rekomandimet e grave në këto forume përfshinin: një kuotë minimale prej 30 përqind për gratë në proceset vendimmarrëse, garancitë statutores për të drejtat e grave dhe trajtim të barabartë, masa të veçanta që sigurojnë riintegrimin e grave të zhvendosura, të drejtat e grave për pronësinë dhe trashëgiminë e pronës dhe adresimin e mosndëshkimit të autorëve për krimet me bazë gjinore. Në Burundi, Irlandën e Veriut dhe Guatemalë, gratë arritën të përfshijnë disa nga këto propozime në marrëveshjet përfundimtare të paqes.⁴

Shumë ishin kritikë për mungesën e grave në procesin e Dejtonit dhe ndikimit gjinor të modelit të ndarjes etnike të përdorur në Bosnje dhe Hercegovinë.

CIG realizoi një studim hulumtues ku gjeti se Kosova dhe Serbia negociuan në Bruksel për më shumë se 10 vjet rreth 50 dokumente, të përbëra nga rreth 150 faqe, të konkluduara në 21 marrëveshje, me 9 të zbatuara, 6 kryesisht të zbatuara, 4 pjesërisht të zbatuara dhe 2 të pazbatuara. Në total, rreth 80 përqind e marrëveshjeve të Brukselit janë zbatuar. Kur disa thonë se Serbia dhe Kosova kanë arritur 33 marrëveshje, e të tjerë thonë 36 apo 47, të gjithë kanë të drejtë. Disa e konsiderojnë secilin nga rreth 50 dokumentet që palët negociuan si marrëveshje. Por jo të gjitha këto dokumente janë marrëveshje; disa janë modifikime, rishikime, përmirësime dhe plane të zbatimit. Për shembull, *Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes* përbëhet nga katër dokumente: marrëveshja thelbësore e nënshkruar në 2011 dhe tre 'rishikime' në 2016, 2017 dhe 2022. Janë gjithashtu rreth 18 certifikata—nga gjithsej 52—të cilat janë njohur reciprokisht por u negociuan në faza të ndryshme të dialogut. Në këtë dokument, për shembull, të gjitha certifikatat janë përfshirë në *Marrëveshjen e Odave Ekonomike*, pasi odat ekonomike ishin kryesisht përgjegjëse për negociimin e tyre. Por marrëveshja e certifikatës ADR⁵ është negociuar veçmas dhe konsiderohet si një marrëveshje më vete.

Ky dokument ka grupuar dokumentet e Brukselit në 21 marrëveshje thelbësore. Si e bëmë këtë? Duke grupuar dokumentet individuale në marrëveshje tematike. Për shembull, marrëveshjet për integrimin policor, integrimin e mbrojtjes civile dhe komandanti rajonal i policisë në veri të Kosovës - tri marrëveshje - janë grupuar të gjitha në një marrëveshje: Integrimi i strukturave serbe të sigurisë në veri të Kosovës, sepse të gjitha përshtaten në fushën e sigurisë dhe të gjitha u negociuan në të njëjtën kohë në Bruksel. Por, për shembull, marrëveshja për Urën e Mitrovicës nuk është përfshirë në Lirinë e Lëvizjes, sepse, përveç elementeve të lirisë së lëvizjes, ajo përfshin

³ Studimi Global mbi Zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, UN Women, New York, 2015, fq. 37-63

⁴ Ibid

⁵ Certifikatat ADR - certifikatat për drejtuesit e mjeteve dhe certifikatat për automjetet. Marrëveshja bazohet në Konventën e OKB-së për certifikatat ADR (Marrëveshja e 30 shtatorit 1957 në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme Rrugore) dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane për transportin e mallrave të rrezikshme.

edhe një dispozitë për një 'demarkacion të kufirit' ndërmjet Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut, dhe u negociua gjithashtu si një marrëveshje e veçantë.⁶

Hulumtimi gjeti se perspektiva gjinore nuk ishte reflektuar në dialog. Disa nga marrëveshjet, si integrimi i strukturave serbe të sigurisë në veri të Kosovës, i vunë gratë në disavantazh. Nga rreth 700 vende pune në strukturat e sigurisë së Kosovës, të gjitha iu dhanë burrave. Pjesëmarrja e grave në dialog ishte gjithashtu shumë e ulët, veçanërisht në nivelet vendimmarrëse.

Të gjithë procesit i mungonte një ekuilibër i duhur gjinor. Gratë e Kosovës dhe Serbisë nuk janë përfshirë sa duhet as në procesin aktual. Pala e BE-së ka bërë më mirë: dy lehtësues të dialogut të BE-së ishin gra—shefet e politikës së jashtme dhe të sigurisë të BE-së Catherin Ashton dhe Federica Mogherini. Përveç Edita Tahirit, e cila ishte kryenegociatore e Kosovës, delegacionet e Serbisë dhe Kosovës janë kryesisht, nëse jo plotësisht, të përbërë nga burra. Një pjesëmarrëse vuri në dukje se megjithëse më shumë gra marrin pjesë në diskutimet teknike, numri është ende dukshëm më i ulët se ai i burrave, duke shtuar se “gratë nuk ishin fare të pranishme në rreth 60 përqind të diskutimeve.”

“Kjo duhet të ndryshojë dhe shpejt.” Dialogu duhet të pasqyrojë përfaqësim më të mirë gjinor jo vetëm në dialog, por edhe në politikëbërjen në vend. “Është e pamundur të diskutohet roli i gruas në dialog nëse nuk diskutohet për pozitën e gruas në shoqëri,” theksoi një pjesëmarrëse. Edhe pse shumë pranuan se situata për gratë tani është më e mirë në Serbi dhe Kosovë, kjo nuk u arrit lehtë. Ishte një proces i gjatë, i shtyrë kryesisht nga institucionet ndërkombëtare, por edhe nga dëshira e Serbisë dhe Kosovës për t'u bërë pjesë e arkitekturës politike dhe të sigurisë evropiane. Për shembull, një ndryshim thelbësor ndodhi përmes ligjeve të reja zgjedhore të miratuara me ndihmën e OSBE-së që vendosi kuota për gratë.

Kjo pjesë e legjisllacionit afirmativ si në Kosovë ashtu edhe në Serbi i ndihmoi gratë të fitojnë më shumë hapësirë në rrymën kryesore politike kombëtare.⁷ Megjithatë, nuk mjafton, pasi ligjet për barazi gjinore parashohin kuotën 50 përqind për gratë, ndërsa ligjet zgjedhore në Serbi dhe Kosovë nuk janë të harmonizuara me to dhe parashikojnë të paktën 40 përqind dhe 30 përqind të “gjinisë më pak të përfaqësuar.” Shumë gra politikane u bënë të rëndësishme në jetën politike fillimisht përmes kuotave, por tani kanë krijuar profilet e tyre, tha një pjesëmarrës. “Imazhet e tyre publike janë të forta dhe disa janë bërë lidere të fuqishme,” veçanërisht në Kosovë ku sistemi zgjedhor me lista të hapura u mundëson atyre të fitojnë drejtpërdrejtë vota individuale dhe kështu të bëhen më të pavarura nga lidheshet partiake të dominuara pothuajse tërësisht nga burrat. Në Serbi, sistemi zgjedhor bazohet ende në lista të mbyllura, duke i lejuar udhëheqjet e partive të hartojnë listat e kandidatëve. Një pjesëmarrës sugjeroi që Serbia gjithashtu të “hapë listat zgjedhore.”

Pavarësisht këtyre përparimeve, pabarazia gjinore mbetet një shqetësim në të dyja shoqëritë.

Pjesëmarrësit rekomanduan që dialogu në fazat e ardhshme t'u mundësojë më shumë grave të marrin pjesë në mënyrë domethënëse në delegacionet negociuese dhe në procesin e zbatimit.

⁶ Shih Shpëtim Gashi, Igor Novaković, Marrëveshjet e Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një vlerësim sasior i zbatimit, Fondacioni Friedrich Ebert, 2020, <http://www.cigonline.net/wp-content/uploads/2021/02/17009-1.pdf>

⁷ Në Serbi Ligji për Zgjedhjen e Deputetëve (amendamentet në 2003 dhe 2020) – Neni 40a. Në Kosovë Ligji Nr. 003/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme – Neni 27.

Një pjesëmarrëse argumentoi se përfshirja e grave në proceset e negociatave rrit shanset për paqe. Disa ishin skeptikë për këtë. “Nuk ka të bëjë vetëm me përfaqësimin, por edhe me atë që ju sillni në tryezë,” u përgjigj një pjesëmarrës. “Nuk jam i sigurt nëse Vjosa Osmani apo Ana Brnabic do të sillnin ndryshime të rëndësishme në tryezë.” Një folës tjetër insistoi se “nuk ka dallim mes deputetëve në Kosovë, burrat dhe gratë kanë një perspektivë mjaft të ngjashme për dialogun.” Por shumica e pjesëmarrësve tjerë thanë se përfshirja e madhe e grave do të bënte një ndryshim thelbësor në proces dhe në rezultatet e tij.

Shumë theksuan se fokusi duhet të jetë te përfshirja. “Dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës është pjesë e një procesi më të madh që duhet të përfshijë gjithashtu normalizimin midis burrave dhe grave,” argumentoi një pjesëmarrëse. Kur mbarojnë luftërat, rezultatet e tyre prekin më shumë gratë sesa burrat. Ajo tha se nuk mjafton vetëm t’i jepet fund konflikteve dhe luftërave. Pa gratë e përfshira në proceset e pasluftës, “nuk ka paqe, vetëm mungesë lufte.” Me fjalë të tjera, pa përfshirjen e grave në dialog, nuk do të ketë normalizim kuptimplotë brenda dhe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Burrat vendosin kur të shkojnë në luftë dhe kur të bëjnë paqe,” zakonisht duke nënshkruar një copë letër.

Por “fitimi i paqes është mbi supet e grave,” të cilat zakonisht “përqendrohen në çështjet që lidhen me jetën.” Një pjesëmarrës theksoi se kjo mund të ilustruhet nga mënyra se si liderët dërgojnë mesazhe për dialogun. “Ata shkojnë në Bruksel dhe thonë se ne do të fitojmë, në vend që të thonë se do të arrijmë një marrëveshje. Kjo është një narrativë e pushtetit dhe duhet ndryshuar.” Ndonjëherë diskursi është gjithçka, pasi është vendimtar për sigurimin e një pranimi më të gjerë shoqëror të marrëveshjeve dhe zbatimit. “Do të ishte me vend që të përfshihej perspektiva e grave për pushtet—se pushteti duhet të jetë diçka që “ndahet me njëri-tjetrin”, e që është në kundërshtim me perspektivën e zakonshme të burrave të “pushtetit mbi dikënd tjetër.”

Një tjetër pjesëmarrës tha se ndonjëherë e gjithë historia reduktohet në shtimin e grave në proces. “Kjo ka të bëjë me një transformim shoqëror, jo vetëm për të “shënuar kutinë.” Pjesëmarrësi iu referua përfshirjes së grave në politikë. Një tjetër pjesëmarrëse vuri në dukje se “gratë janë të ngujuara në rolet e tyre shoqërore, gjë që e bën më të vështirë për to përfshirjen në sfera të tjera.” Disa argumentuan se për të rritur ndikimin e tyre, gratë duhet të bëhen palë në procese, me fuqi solide për të formësuar vendime. Një pjesëmarrës theksoi se dialogut i mungonte seriozisht përfaqësimi i grave nga komuniteti lokal serb në Kosovë. “Dhe është e qartë se disa çështje për të cilat ata shqetësohen, mungojnë në dokumentin e propozuar nga BE-ja.”

Perspektiva gjinore në dialogun Kosovë-Serbi

Marrëveshja ndërmjet Serbisë dhe Kosovës është marrëveshje për normalizim, por nuk ka normalizim të plotë pa perspektivën gjinore. Në këtë fazë dhe me përbërjen aktuale të procesit (d.m.th., i përqendruar te drejtuesit) është e vështirë të pritet që diçka të ndryshojë, përveç ndoshta gjatë fazës së zbatimit. Një pjesëmarrës pyeti se si të përfshihen më shumë gra në dialog ose potencialisht si të diskutohen elementet e dialogut dhe konkluzionet e tij përmes ndonjë formati shtesë. Të tjerë iu referuan edhe mungesës së transparencës në dialog.

Një tjetër pjesëmarrës dha një propozim alternativ. Në vend që të kërkohet një rikompozim i procesit mund të ketë një mekanizëm që do të siguronte një auditim të perspektivës gjinore për elementet e dakorduara. Ky lloj auditimi mund të sigurojë një mekanizëm për integrimin e çështjeve gjinore dhe perspektivave gjinore rreth marrëveshjeve dhe, nëpërmjet tij, një ndikim të mundshëm në fazat vijuese të procesit. “Auditimi duhet të kryhet nga një grup i balancuar gjinor dhe duhet të ofrojë një perspektivë se si marrëveshja(et) ndikojnë në barazi.”

Shumë pjesëmarrës ranë dakord, duke theksuar se kjo do të tregonte se ka qasje alternative, por edhe çështje të anashkaluara që, nëse përfshihen, do të rrisnin ndjeshëm shanset për paqe dhe bashkëpunim. Disa theksuan se gjërat mund të përmirësoheshin nëse auditimi i orientuar në gjini do të ndikonte në dialog dhe në rezultatet e tij.

Një folës tha se nëse ky plan realizohet, ndikimi nuk do të vijë menjëherë. Por në planin afatgjatë do të mund të bënte një ndryshim të vërtetë. Ajo theksoi se gjëja më e rëndësishme është të ketë burra që janë vendimmarrës dhe të krijojnë partneritete me ta. Kështu, auditimi i bazuar në gjini duhet të shpërndalet dhe mbështetet edhe nga burra që janë vendimmarrës.

Pjesëmarrësit debatuan se si të materializohet auditimi i bazuar në gjini. Disa propozuan një grup pune të përhershëm për të kanalizuar dhe shikuar dialogun dhe për të audituar draft-marrëveshjet nga perspektiva gjinore. Të tjerë theksuan se shumë prej tyre janë politikanë dhe se besnikëria ndaj partive të tyre mund të bie ndesh me kryerjen e një auditimi në shkallë të përhershme. “Ne do të detyroheshim të zgjidhnim midis besnikërisë ndaj gjinisë dhe besnikërisë ndaj partisë.” Edhe jopolitikanët thanë se po merren çdo ditë me dialogun dhe se do mund të kontribuonin më shumë në një format që do të ishte më pak formal.

Pjesëmarrësit ranë dakord se mënyra më e mirë do të ishte vazhdimi i këtij diskutimi përmes përpjekjeve formale, por veçanërisht joformale, siç është kjo tryezë e rrumbullakët, pasi mundëson më shumë përfshirje dhe diskutime të hapura. Një format jozyrtar u mundëson pjesëmarrësve të “sjellin më shumë çështje në tryezën zyrtare.” Pjesëmarrësit u dakorduan që diskutimi mbi përfshirjen dhe barazinë gjinore duhet të bëhet një aspekt qendror i debatit të politikave dhe politikëbërjes në Serbi dhe Kosovë.

Pjesëmarrësit realizuan një ‘auditim’ të marrëveshjes së Ohrit.

Pjesëmarrësit

Rendi alfabetik anglez

Gresa Baftiu, Përfaqësuese në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Gordana Comic, Ish-ministre për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave dhe Dialogun Social,
 Qeveria e Serbisë
Blerta Deliu Kodra, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës
Natasha Gacesa, Sekretare Ndërkombëtare, Partia Socialiste e Serbisë
Shpëtim Gashi, Nënkyetar, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Ardian Gjini, Nënkyetar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Dushan Jovanoviç, Sekretar Ndërkombëtar, Mos e Lini Beogradin të Përmytet
Mimoza Kusari Lila, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Shqipe Mjekiqi, Nënkyetare, Lidhja Demokratike e Kosovës
Igor Novakovic, Përfaqësues në Serbi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Fitore Pacolli, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Cristina Plesoianu, Zyrtare për Çështje Politike, UNMIK
Jovana Radosavljevic, Drejtore Ekzekutive, Iniciativa e Re Sociale
Sanda Raskovic Ivic, Deputete e Parlamentit të Serbisë, Partia Popullore e Serbisë
Alex Roinishvili Grigorev, Kryetar, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Dragan Sormaz, Ish-deputet i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe
Sanja Sovrlic, Gazetare
Jeta Statovci, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Javiera Thais Santa Cruz, Këshilltare për Çështje Gjimore, UNMIK
Visar Ymeri, Drejtor Ekzekutiv, Instituti Musine Kokollari

¹ Tryeza u mbështet nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Raporti është një përmbledhje e shkurtër e diskutimeve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e pjesëmarrësve individualë, CIG-së dhe Kombeve të Bashkuara.